



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR			
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA			
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Nr. lista Org. Org. Jedinica Org. Unit	M-01	Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	1131/26
Nr. i faqeve Broj. stranica No. pages	03	Data. Datum: Date:	10.03.2026
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e mjedisit dhe Planifikimit hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog planiranja
Ministry of Environment, Spatial and Planning

Ministrja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 93 paragrafit 4 të Kushtetutës së Kosovës, në përputhje me nenin 11 nënparagrafi 1.5 i Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.34/2022), të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.7/2019), nenin 17 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Rregullores Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, në nenin 6, 13, 22, 34, 81 dhe dispozitave të tjera të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2013), në mbështetje të nenit 5 paragrafi 2 dhe 3 dhe të nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrotjtjen e Mjedisit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 50/2009), në Rishikimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023 - 2027 dhe Plani i Veprimit 2023 – 2025, Udhëzimin Administrativ Nr.12/2013 Për Sistemin Informativ Ujor, si dhe dispozitave tjera ligjore të ligjtit në fuqi, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për marrjen e masave për rikthimin e rrjedhës së lirë natyrore të lumenjve në territorin e Republikës së Kosovës.
Ky vendim inicion procesin ligjor dhe teknik për identifikimin, vlerësimin dhe heqjen graduale të të gjitha pengesave, strukturave hidroteknike, digave të vogla, pragjeve dhe pengesave të tjera artificiale në shtretërit e lumenjve, të cilat konstatohen si të dëmshme për regjimin natyror të lumenjëve jashtë funksionit, të braktisura ose që kanë humbur qëllimin e tyre fillestar.
2. Obligohet Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL) brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojnë dhe dorëzojnë Inventarin Kombëtar të pengesave në lumenj, të përcaktuara ne pikën 1 të këtij Vendimi.
Inventari duhet të kategorizojë strukturat e braktisura dhe të padobishme që nuk kryejnë asnjë funksion aktiv, të cilat do të propozohen për heqje të plotë.

3. Largimi i këtyre strukturave ka për synim rikthimin e rrjedhës së pa penguar të lumenjve dhe rrugëve të migrimit për faunën ujore, përmirësimin e transportit natyror të sedimenteve dhe zvogëlimin e rrezikut nga përmytjet që vijnë si pasojë e bllokimit të këtyre barrierave të papërmbajtura nga mbeturinat dhe drunjtë gjatë prurjeve të mëdha.
4. Gjatë procesit të identifikimit dhe prioritizimit për heqje, Ministria do të bashkërendojë aktivitetet me Komunitetet përkatëse, organizatat e shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit dhe komunitetin shkencor.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit, Inspektorati Qendror i Mjedisit, Ujërave, Natyres, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL) si dhe institucionet e tjera përkatëse.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Ky vendim mbështetet në Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, i cili obligon institucionet për mbrojtjen, përmirësimin dhe rehabilitimin e resurseve ujore. Po ashtu, nisma është në harmoni me Direktivën Kornizë të Ujërave të BE-së (2000/60/EC) dhe Strategjinë e BE-së për Biodiversitetin 2030, e cila synon rikthimin e rrjedhës së lirë në të paktën 25,000 km lumenj në Evropë përmes heqjes së barrierave të vjetëruara.

Gjatë dekadave të fundit, në shtretërit e lumenjve të Kosovës janë ndërtuar struktura të shumta si pragje, diga të vogla, mure devijuese dhe të tjera për nevoja që sot nuk ekzistojnë më (ish-mullinj, sisteme të vjetra vaditjeje apo objekte industriale të braktisura). Këto struktura janë identifikuar si barriera "vdekjeprurëse" për ekosistemin. Ato pengojnë migrimin e peshqve dhe organizmave të tjerë ujorë, duke çuar në rënien e biodiversitetit. Pengesa hidrologjike bllokojnë sedimentet natyrore, duke shkaktuar erozion poshtë rrjedhës dhe degradim të shtratit të lumit. Barrierat e vjetëruara shërbejnë si pika grumbullimi për mbeturinat dhe mbetjet drunore, duke u bërë shkaktarë kryesorë të vërshimeve dhe dëmtimeve të infrastrukturës gjegjësisht urave gjatë prurjeve të mëdha.

Përmes këtij vendimi, Ministria synon të kalojë nga menaxhimi pasiv në ndërhyrje aktive për restaurimin e lumenjve. Heqja e këtyre barrierave do të sjellë përmirësimin e cilësisë së ujit ku rrjedha e lirë mundëson vetëpastrimin natyror të lumit. Rritjen e qëndrueshmërisë ndaj klimës ku lumenjtë pa pengesa menaxhojnë më mirë sasinë e ujit gjatë krizave klimatike.

Procesi do të jetë transparent dhe i bazuar. Përmes Inventarit Kombëtar, secila strukturë do të vlerësohet nëse ka ende funksion ekonomik apo social. Nëse konstatohet se struktura është jashtë funksionit, ajo do të procedohet për largim, gjithmonë në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe komunitetin.

Mbi bazën e këtyre pikave, vlerësohet se iniciimi i këtij programi është një hap drejt mbrojtjes së pasurisë ujore të Republikës së Kosovës dhe përmbushjes së standardeve mjedisore ndërkombëtare.

Projektet për heqjen e pengesave do të përfshihen si prioritet në planifikimin buxhetor të Ministrisë për vitet në vijim, si dhe do t'u prezantohen donatorëve ndërkombëtarë për bashkëfinancim.

Vendimi u dërgohet:

- Kabinetit të Ministres të MMPH-se;
- Sekretari i Përgjithshëm;
- Inspektorati i Ministrisë;
- ARPL;
- Divizioni për Komunikim Publik;
- Komunave përkatëse;
- Arkivi i MMPH-së.

Fitore Jacolli Dalipi

Ministre e MMPH-së

